

## REAGIM PER MEDIAT

Qendra për Çështje të Informimit Publik dënon dhunën e ushtruar ndaj gazetarit të njohur Mero Baze natën e 2 Nëntorit, në mes të Tiranës.

Qendra për Çështje të Informimit Publik konstaton pa mëdyshje se gazetari Mero Baze është dhunuar për shkak të detyrës dhe të kurajos profesionale që ai ka demonstruar së fundmi në investigimin e aferave korruptive në fushën e privatizimeve strategjike në sektorin e naftës, ku implikohen interesa të zyrtarë të lartë në pushtet.

Qendra për Çështje të Informimit Publik shpreh indinjatën e thellë që akti i dhunimit fizik të gazetarit Mero Baze ka ndodhur në prani të dy kolegëve të tjerë gazetarë që e shoqëronin atë, konkretisht Andi Bushati dhe Arban Hasani.

Qendra për Çështje të Informimit Publik jep alarmin se në Shqipëri po tentohet të adaptohen modele alla-ruse sjelljeje, ku oligarkët e naftës që prodhohen nga pushteti, zhdukin apo dhunojnë gazetarët që iu kundërvihen në emër të së vërtetës, lirisë së fjalës dhe përmbushjes së detyrës për informimin e publikut.

Në një shoqëri demokratike fjala është e vetmja armë kurse debati publik është e vetmja luftë. Dhuna fizike është tipari më dallues i shoqërive barbare. Përsëritje a akteve të dhunës, për me tepër ndaj një gazetari kritik ndaj pushtetit dhe afaristëve që ushqehen prej pushtetit, është një tregues i pamohueshëm që shoqëria shqiptare po pëson një kthesë të rrezikshme dhe alarmante në drejtimin e gabuar.

Shqiptarët sot ka të gjitha arsyet të ndjehen të alarmuar për drejtimin ku po futet vendi, kurse gazetarët shqiptarë kanë të gjitha arsyet të protestojnë me të gjitha mënyrat që kanë në dispozicion ndaj realitetit të dhunshëm ku ata po i përplas oligarkia barbare që ka prodhuar pushtetit politik gjatë këtyre viteve.

Qendra për Çështje të Informimit Publik bashkohet me apelin publik të bërë nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë që fton editorët e mediave shqiptare në shenjë proteste të lenë sot, më 3 nëntor 2009, pesë minuta "të zezën" (black) në edicionet informative te televizioneve të vendit dhe një sipërfaqe botimi të bardhë në shtypin e përditshëm të printuar.

**Gerti Shella**

Qendra për Çështje të Informimit Publik, ÇIP



TIRANE 03 / 11 / 2009